

Qendra Burimore e Alternativave të Zhvillimit

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 10.03.2009
- Statusi Ligjor: Organizatë jofitimprurëse,
- Selia Qendrore: Rruga Gjig Kuqali Pall.Melrose, Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: <https://www.facebook.com/DARC.org.al>
- Email kryesor i organizatës: alternativazhvillimi@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355694096555

2. Misioni

DARC është një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar për të kontribuar në transformime pozitive sociale-ekonomike dhe mjedisore, duke gjeneruar dhe shpërndarë njohuri në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe adresimit të çështjeve rajonale dhe lokale. Synimi ynë është të nxisim marrjen e vendimeve të informuara, të promovojmë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përmirësojmë mirëqenien e komuniteteve përmes kërkimit inovativ, edukimit dhe angazhimit komunitar.

DARC kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor, duke përfshirë praktika miqësore me natyrën, hulumtime për politikat klimatike dhe përfshirjen e komuniteteve në mbrojtjen e burimeve natyrore.

3. Vizioni (Opsionale)

Të ndërtojmë një shoqëri gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të drejtë, ku çdo individ ka mundësi të barabarta për zhvillim personal dhe kontribut aktiv në mirëqenien e komunitetit dhe mbrojtjen e mjedisit.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

- **Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve dhe studimeve në fusha specifike** si të drejtat e njeriut dhe përfshirja sociale, punësimi dhe aftësitë, integrimi në BE, statistikën, kërkimin shkencor dhe inovacionin, qeverisja vendore dhe procesi i decentralizimit, duke përfshirë edhe dimensionin e qëndrueshmërisë mjedisore në të gjitha proceset.
- **Vlerësime cilësore dhe sasore**, si dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve qendrore dhe vendore për të monitoruar zbatimin e qasjeve të bazuara në barazi gjinore, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor.
- **Mbështetje për institucionet publike dhe bashkitë** përmes analizave dhe aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve në hartimin e standardeve, zbatimin dhe monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike cilësore dhe miqësore me mjedisin.
- **Mbështetje dhe rrjetëzim me OSHC-të, pushtetin vendor dhe komunitetin**, në përgatitjen e udhëzuesve për zhvillimin e komunitetit, menaxhimin e qëndrueshëm, pjesëmarrjen qytetare dhe politikat e ndjeshme ndaj gjinisë dhe mjedisit.

Qendra Burimore e Alternativave të Zhvillimit

- **Organizimi i konferencave, seminareve, publikimeve dhe mjeteve të tjera të ndërgjegjësimit publik**, promovimi dhe informimi mbi çështje të zhvillimit social e ekonomik, të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale, zhvillimit kulturor dhe ndikimit të ndryshimeve klimatike në komunitet.
- **Organizimi, strukturimi dhe fuqizimi i grupeve vulnerabël, OSHC-ve apo grupeve të interesit**, si dhe ofrimi i udhëzimeve dhe mbështetjes në të gjitha format kur është e nevojshme – përfshirë edhe për të marrë pjesë aktive në mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve të tyre.
- **Krijimi i programeve kundër korrupsionit në nivel vendor**, standardizimi i procedurave, ngritja e qendrave të informacionit dhe kanaleve të komunikimit midis autoriteteve vendore dhe qytetarëve, duke përfshirë gjithashtu transparencën në menaxhimin e burimeve natyrore dhe buxheteve të gjelbra.

4. Aktivitetet/Programet Kryesore

1. IPA-ADRION 530 – AdRIAtic-ian Nature based solutioNs enhAncement – ARIANNA
Projekti përfshin zhvillimin e një metodologjie të unifikuar për vlerësimin e veprimeve pilot në Rajonin Adriatik, organizimin e Grupeve Lokale për të mbledhur mendimet e palëve të interesuara, për Ndërtimin e Kapaciteteve që përfshijnë autoritetet publike, shkollat, NVM-të dhe shoqërinë civile. Ai promovon shkëmbimin e njohurive mbi Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë (ZBN) për parandalimin e fatkeqësive klimatike—veçanërisht për zbutjen e përmbytjeve—mbështet formalizimin e Rrjetit ARIANNA përmes një Memorandumi Mirëkuptimi (MoU), eksploron mundësi të ardhshme për projekte ndërkufitare mbi qëndrueshmërinë ndaj klimës dhe ZBN-të, dhe advokon për integrimin e mjeteve ARIANNA në politikat klimatike lokale dhe rajonale.

2. Qender Sociale Multifunkionale e Bazuar ne Komunitet
Qëllimi kryesor i projektit është të përmirësojë përfshirjen sociale dhe cilësinë e jetës për fëmijët, të rinjtë dhe gratë nga familjet me status ekonomik të pafavorshëm në Bashkinë Kavajë, duke krijuar një Qendër Sociale Multifunkionale bazuar në komunitet.
Ky projekt synon: (i) ofrimin e shërbimeve sociale të përshtatura sipas nevojave të grupeve vulnerabël; (ii) krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për akses në informacion dhe mundësi; (iii) nxitjen e angazhimit komunitar dhe uljen e stigmatizimit social ndaj vulnerabilitetit

3. Projekti "Vlerësim Cilësor dhe Kontribut për Hartimin e një Kuadri Zbatimi për Përmirësimin e Aksesit në Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve për Minoritetet Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri"

Projekti kishte për qëllim të identifikonte barrierat që pengojnë aksesin e këtyre komuniteteve në shërbimet bazë. U hartëzuan ndërmarrjet që mbulojnë zona me përqendrim të lartë rom dhe u realizuan vlerësime cilësore, në bashkëpunim me komunitetin dhe organizatat lokale. Gjetjet u prezantuan në një punëtori për të propozuar masa konkrete që mund të integrohen në planet e ndërmarrjeve ose të adresohen në nivel qendror. Bazuar ne rezultatet e arritura, u përgatitën rekomandime për përfshirjen e masave të posaçme në Manualin e Operacioneve të projektit.

6. Shtrirja Gjeografike

Qendra Burimore e Alternativave të Zhvillimit

Një përshkrim i shkurtër e vendeve ku operon organizata ose ku ka projekte aktive (vendet specifike, rajonet, qytetet),

Organizata operon aktualisht në të gjithë Shqipërinë, duke u bazuar në partneritete të vendosura me bashkitë si dhe me Agjenci të ndryshme publike dhe private. Gjithashtu DARC ka ngritur partneritete edhe në rajon ku po zbaton me sukses projekte ndërkufitare, që përfshin bashkëpunime ndërkufitare dhe ndërkombëtare në kuadër të programeve rajonale.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Elda Kapllani

Bordi i Drejtuesve: Daniela Ismailaj

Nevila Como

Sherif Kapllani

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Një përmbledhje e shkurtër që thekson partnerët, donatorët ose bashkëpunëtorët kryesorë që ka patur organizata.

Gjatë viteve, organizata ka zhvilluar bashkëpunime të frytshme me një sërë partnerësh vendorë dhe ndërkombëtarë, duke ndërtuar një rrjet të gjerë mbështetjeje për zbatimin e projekteve në fushat e zhvillimit social, përfshirjes dhe mirëqeverisjes. Një pjesë e rëndësishme e këtij bashkëpunimi ka qenë me bashki të ndryshme në Shqipëri, me të cilat janë realizuar nisma për forcimin e shërbimeve, pjesëmarrjen qytetare dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Mbështetës të rëndësishëm janë treguar gjithashtu One Telecommunications, përmes përfshirjes në projekte të përgjegjshmërisë sociale dhe dixhitalizimit, si dhe Banka Botërore, që ka kontribuar në analizën dhe zhvillimin e politikave publike në nivel vendor.

Në këtë rrugëtim, një rol të veçantë kanë luajtur edhe partnerë ndërkombëtarë si GIZ Albania, Bashkëpunimit Zviceran, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) dhe **Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), të cilët kanë ofruar mbështetje financiare dhe teknike për ndërhyrje që synojnë përmirësimin e mbrojtjes mjedisore, fuqizimin e aktorëve lokalë dhe nxitjen e axhendes green në fokusin e organizatës. Këto bashkëpunime kanë qenë thelbësore për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe me ndikim në komunitet.

9. Ndikimi (Opsionale)

Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme. Për shembull:

- [Numri] i njerëzve të përfshirë në x aktivitet
- [Numri] i pemëve të mbjella
- [Numri] i politikave të influencuara

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

Çdo zhvillim i fundit, çmime ose shfaqje në media për organizatën.

-